



Regjistri mujor i aktiviteteve të kërkimit për punë sipas ligjit "Për novacionin dhe mundësitë e fuqisë punëtore" (Workforce Innovation and Opportunity Act, WIOA) (Albanian)

Emri: _____

Numri i çështjes: _____

Nëse dëshironi të vazhdoni të merrni përfitimet e Programit të ndihmës ushqimore suplementare (Supplemental Nutrition Assistance Program, SNAP), duhet të:

- Shpenzoni të paktën 80 orë çdo muaj duke kërkuar për punë ose duke marrë pjesë në aktivitete të caktuara të miratuara kërkimi për punë,

DHE

- Dorëzoni çdo muaj dëshmi të tentativave tuaja të kërkimit për punë.

Përdorni formularin në faqen tjetër për të gjurmuar ecurinë tuaj. Nënshkruani dhe datoni formularin e plotësuar. Më pas, kthejeni formularin tek ofruesi i PACE-s i specifikuar në faqen e fundit. Dëshminë tuaj duhet ta dorëzoni përpara çdo fund muaji.

Këtu jepen disa shembuj të gjërave që mund të regjistroni në këtë formular për të arritur 80 orët e kërkuara në muaj. Kjo nuk është një listë shteruese.

- Kërkimi për punë
- Shqyrtimi i punëve të disponueshme
- Plotësimi dhe dorëzimi i aplikimeve për punë (në internet ose personalisht)
- Përgatitja për intervista pune ose pjesëmarrja në to
- Pjesëmarrja në seminare kërkimi për punë ose bashkëpunimi me një specialist punësimi

Për të gjetur vende të lira pune, përdorni <https://jobzone.labor.ny.gov/> ose <https://myjobsny.usnlx.com/jobs/>



JobZone

Skanoni për të gjetur punë që përputhen me aftësitë tuaja

Faqja e internetit:

<https://jobzone.labor.ny.gov/>



New York State Job Bank (Banka e punëve e shtetit të Nju-Jorkut)

Skanoni për të kërkuar dhe aplikuar për vende të lira pune

Faqja e internetit:

<https://myjobsny.usnlx.com/jobs/>

Vini re: Teksa ju inkurajojmë të përdorni të gjitha burimet e disponueshme për kërkimin tuaj për punë, do të llogaritet vetëm koha e shpenzuar në këto faqe interneti. Mos renditni faqe të tjera kërkimi për punë në faqen vijuese të këtij dokumenti.

(Ktheni faqen)

**Regjistri mujor i aktiviteteve të kërkimit për punë sipas ligjit
"Për novacionin dhe mundësitë e fuqisë punëtore"
(Workforce Innovation and Opportunity Act, WIOA) (vazhdim)**

MËNYRAT SI TA KTHENI KËTË FORMULAR TEK OFRUESI I PACE-S



ME EMAIL — _____



Sillni kopje të dokumenteve në:
PERSONALISHT — _____



DËRGONI ME FAKS dokumentet në _____